**VENDIM**
**Nr.185, datë 31.3.2005**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT DHE KALIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË ZYRAVE TË INSTITUTIT TË SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR, DEGA BERAT, SHËRBIMIT TË PËRMBARIMIT GJYQËSOR TË KËTIJ RRETHI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 shkronja "c" të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit dhe kalimin e përgjegjësisë së administrimit të zyrave të Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, dega Berat, Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor, institucion në varësi të Ministrit të Drejtësisë, për zyrën e përmbarimit të këtij rrethi, me sipërfaqe 100 $m^2$, përkatësisht sipas formularit nr.1 dhe planimetrisë, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor, zyrës së përmbarimit, Berat, i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e kësaj prone, ta tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.

3. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Fatos Nano**

# 1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
## (Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Institucioni i Pushtetit Qendror: Instituti i Sigurimeve te Kujdesit Shendetesor — Identifikoi: Liljana Kurti (Specialiste ne Sektorin e Kontabilitetit) (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Bashkia / Komuna: BERAT — Supervizoi: Leonora Horanlliu (Pergjegjese e Sektorit te Kontabilitetit) (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Fusha e perdorimit te Prones: Sigurimi i Kujdesit Shendetesor — Aprovoi: GJERGJI LEKA (DREJTOR I PERGJITHSHEM) (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel, firma, vula)

| | A | | | B | | | C | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. Rend. | Zona Kadastr.& Indeksi i Hartes | Nr. Pasurise | Lloji i Prones | Emri i Prones Adresa | Sip. Totale e Prones ($m^2$) | Nga Sip. Totale: Sa Ndertese ($m^2$) | Funksioni per te Cilin perdoret Prona | Institucioni/Enti me pergjegjesi administrative | Institucioni/Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit | Te dhena te tjera (Shenime te veçanta) |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| 1 | | | | Drejtoria Rajonale e Sigurimit te Kujdesit Shendetesor Berat. Adresa: Lagjja "30 vjetori", Ish poliklinika e vjeter, Berat | 100 $m^2$ | 100$m^2$ | Blerje e sherbimit farmaceutik mjeksor | Instituti i Sigurimeve te Kujdesit Shendetesor Tirane | Drejtoria Rajonale e Sigurimeve te Kujdesit Shendetesor Berat. Prona eshte kalim kapital nga ish ndermarrjet farmaceutike me urdher te Ministrise se Shendetesise me 1996 | Drejtoria Rajonale e Sigurimeve te Kujdesit Shendetesor Berat e zhvillon aktivitetin ne mjediset e ish poliklinikes se vjeter Berat, te bera kalim kapital me urdher te Ministrise se Shendetesise, Nr. 278, date 17.12.96 |

Dep. e Higjienës
Drejt. e Shëndetit
Dega investimeve
Berat

# SKEMA PLANIMETRIKE E ZYRAVE TE I.SH.K.SH

SH 1:100




Shënim: 1) Kati dytë – Zyrat e I.SH.K.SH
2) Kati tretë – Zyrat e D.SH.P + I.SH.K.SH. PARESOR

Punoi ing. E. Mendulosi
Nr. lic. K0365

Drejtori
(Denis Hoxha)

Berat
18/11/04